Republika e Kosovës - Republika Kosovo
Komuna e Gjakovës - Opština Djakovica
01 Nr. Br. 112 16274
29.03.2016

**REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA**
**REPUBLIC OF KOSOVO**
**KOMUNA E GJAKOVËS / OPŠTINA DJAKOVICA**
**MUNICIPALITY OF GJAKOVA**

Në bazë të nenit 28.2 të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës nr. 03/L-149 dhe nenit 8.1 te Rregullorës nr. 06/2010 për transferimin e nënpunësve civil, Kryetarja e Komunës së Gjakovës në mbështetje të autorizimeve të përcaktuara me nenin 58.1 (f) të Ligjit për vetëqeverisje lokale nr. 03/L-040 si dhe nenit 41.1 (f) të Statutit të Komunës së Gjakovës, me datën 29.03.2016 merr këtë

## AKTVENDIM

Për transferimin e nëpunësit civil si masë jodisciplinore

1. Nëpunësi civil Z. Pranush Komani, nga vendi i punës Udhëheqës I Personelit, transferohet në vendin e punës Udhëheqës i sektorit për asistencë sociale pranë Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale – Qendra për punë sociale në kuadër të Komunës së Gjakovës.

2. Vendi i ri i punës është i njëjtës gradë sikurse vendi i mëparshëm. Pagesa në vendin e ri të transferuar është identike me pagesën si në vendin e mëparshëm e përllogaritur me koeficientin 9.5

3. Nëpunësi civil Z. Pranush Komani duhet t'ia fillon punën në vendin e ri me datën 30.03.2016

4. Ky Aktvendim hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

## Arsyetim

Duke pasur parasysh nevojën urgjente të Institucionit për plotësim të vendit të punës: Udhëheqës i sektorit për asistencë sociale pranë Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale, pasur parasysh edhe nevojën e ngritjes profesionale të personelit pranë Qendrës për punë sociale e cila funksionon në kuadër të Drejtorisë për shëndetësi dhe mirëqenie sociale të Komunës së Gjakovës, si dhe duke u bazuar në kërkesën e vet punëtorit për këtë transferim i cili kuptohet si pëlqim paraprak të nëpunësit z. Komani konform nenit 8.4 të Rregullorës nr. 06/2010 për transferimin e nënpunësve civil, Kryetarja e Komunës vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij Aktvendimi, nëpunësi civil ka të drejtë ankese sipas dispozitave të Ligjit për shërbimin civil të Republikës së Kosovës.

**Kryetarja e Komunës së Gjakovës:**
znj. Mimoza Kusari - Lila

**I dorëzohet:**
Punëtorit: z. Pranush Komani
Arkivit Komunale